

Tabelë konvertimi nga kW në cm³ për automjetet elektrike apo hibride

Problemi

Aktualisht, grupet tarifore për sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësisë ndaj palëve të treta, varësisht nga lloji i mjetit motorik, janë si më poshtë:

1. Automjete për pasagjer
2. Automjete transportuese/ kamion
3. Autobus Urban
4. Autobus Ndërrurban
5. Traktor
6. Motocikletë
7. Rimorkio

Grupi tarifor automjete për pasagjer është i ndarë në dhjetë nënkategori, varësisht nga **vëllimi punues i motorit** i shprehur në centimetër kub (cm³).

Automjetet për pasagjer elektrike apo hibride, nuk kanë “vëllim punues të motorit” dhe kapaciteti i tyre matet përmes **fuqisë**, shprehur në kilo ëat (kW). Që këtë, nuk ka grup tarifor për sigurimin e tyre, që do të mastë kapacitetin e automjeteve përmes fuqisë së motorit.

Në mungesë të tarifës adekuate, siguruesit kanë përdorur qasje të ndryshme për të ofruar sigurim klientëve, jo gjithëherë uniforme.

Zgjidhja

Janë tri zgjidhje të mundëshme për problemin:

1. Ndryshimi i grupit tarifor automjete për pasagjer, ashtu që kapaciteti i automjetit mos të matet me vëllimin punues të motorit por përmes fuqisë që ai e prodhon. Kjo zgjidhje do të ishte më e mira, por njëkohësisht kërkon ndryshimet më të mëdha, meqë kërkon ndryshimin e tarifimit të të gjitha automjeteve.
2. Hartimi i një grupi të ri tarifor “Automjete Elektrike/Hibride”, zgjidhje e mundëshme por që kërkon analiza më të thella dhe ndryshime të tarifave dhe aprovim nga rregullatori.
3. Hartimi i një table konvertuese, e cila do të shërbente për konvertimin e përafërt të fuqisë punuese të motorit (kW) në “vëllim punues i motorit” cm³, dhe mandej për atë vëllim ekuivalent, të përdoret grupi tarifor aktual.

Për qëllime praktike dhe implementim të shpejtë, në periudhë kalimtare vlen të implementohet zgjidhja e fundit, deri në vendimet e ardhëshme.

Konvertimi nga kW në cm³

Fuqia e prodhuar e motorit dhe vëllimi punues i motorit janë dy madhësi fizike të ndryshme, dhe konvertimi nga njëra tek tjetra nuk është i thjeshtë. Kjo për shkak se i njëjti vëllim punues i motorit, mund të prodhoj fuqi të ndryshme, varësisht nga karakteristikat tjera të tijë.

Sidoqoftë, ekziston një standard që mbulon shumicën e rasteve, që konverton vëllimin punues në fuqi të prodhuar tek automjetet, dhe ajo shprehet përmes formulës së mëposhtme:

$$Fuqia\ e\ motorit = \frac{V_{\text{vllimi i motorit}}}{15} * 0.7457$$

Shembull, për një automjet me vëllim 1900 cm³ (1.9), ekuivalenti në kË do të ishte:

$$Fuqia\ e\ motorit = \frac{1900}{15} * 0.7456 = 94.46\ kW$$

Përmes kësaj formule mund të përdorim tarifën aktuale të automjeteve për pasagjer, sipas tabelës së mëposhtme

Grupi	Prej	Deri	Çmimi i premisë (me TVSH)	E Shprehur ne kW		Në sistem regjistrohet ky kapacitet si pika e mesit
				Prej	Deri	
Grupi Tarifor I, Cm3 Automjete per pasagjer	0	750	74.71	-	37.3	375 cm3
	750	900	89.65	37.3	44.7	825 cm3
	901	1100	110.57	44.8	54.7	1001 cm3
	1101	1300	127.01	54.7	64.6	1201 cm3
	1301	1500	137.47	64.7	74.6	1401 cm3
	1501	1700	156.89	74.6	84.5	1601 cm3
	1701	1950	194.25	84.6	96.9	1826 cm3
	1951	2250	233.10	97.0	111.9	2101 cm3
	2251	2700	268.96	111.9	134.2	2476 cm3
	Mbi	2701	313.79	134.2		3000 cm3

Vërejtje:

Ky konvertim nuk është shkencorë dhe nuk është gjithmonë i saktë dhe ka limitet e tijë. Megjithatë, jep zgjidhje të përkohëshme për trajtimin e automjeteve elektrike/hibride.

Automjetët tjera, vazhdojnë të trajtohen ashtu siq janë duke u trajtuar edhe aktualisht.